


Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**VLERA E KUR'ANIT FISNIK
DHE NDIKIMI I TIJ
NË RUAJTJEN DHE PASURIMIN
E GJUHËS ARABE**



Prof.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**VLERA E KUR'ANIT FISNIK DHE
NDIKIMI I TIJ NË RUAJTJEN DHE
PASURIMIN E GJUHËS ARABE**

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Dr. Hajredin HOXHA

**VLERA E KUR'ANIT FISNIK DHE
NDIKIMI I TIJ NË RUAJTJEN DHE
PASURIMIN E GJUHËS ARABE**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmimin e kulturës së leximit në përgjithësi.

Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të autorit.

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:

Sedat ISLAMI

Recensent: Ajni Sinani

Redaktura gjuhesore: Mimoza Sinani

Titulli në origjinal:

Dr. Hajruddin Huxheh, *Fadlu'l Kur'ani'l Kerim ve etheruhu fi hidhi lugati'l arabijjeh ve ithraiha*, Referim shkencor në seminarin ndërkombëtar “Gjuha arabe ndërmjet zhdukjes dhe evoluimit – sfidat dhe të priturat”, Fakulteti i arteve, Departamenti i Gjuhës Arabe, Universiteti Indonezian i Az'harit, 22-25 korrik 2010, Xhakarta, Indonezi.

Dr. Hajredin HOXHA

**VLERA E KUR'ANIT FISNIK DHE
NDIKIMI I TIJ NË RUAJTJEN DHE
PASURIMIN E GJUHËS ARABE**

Përmbledhje

Është fakt i pranuar se zbritja e Kur'anit në gjuhën arabe ka ndikuar në mënyrë të pamohueshme në stabilizimin dhe përforcimin e kësaj gjuhe, sikurse që ka ndikuar në forcimin e pozitës së saj ndërmjet gjuhëve të tjera, në përmirësimin dhe korrigjimin e saj, në zgjerimin e objektivave të saj ekspresive (shprehëse) dhe arteve të të folurit të saj. Kjo mund të vërehet shumë qartë në shumëllojshmërinë e kuptimeve, imagjinatave, metodave dhe fjalëve. Kur'ani luajti një rol shumë të madh në gjuhën arabe, në letërsinë dhe retorikën e saj, si dhe në kritikën letrare tek arabët. Mrekullia e famshme kur'anore tregoi epërsi ndaj çdo shkathtësie letrare duke shënuar kështu një revolucion në gjuhën arabe, një ngritje të theksuar në letërsinë, retorikën dhe kritikën e saj letrare.

Përgjithësisht, vlera e Kur'anit për gjuhën arabe mund të përmbledhet si vijon:

- Stabilizimi i gjuhës arabe dhe zgjerimi i pushtetit të saj në botë, nëpërmjet përhapjes së Islamit,
- Korrigjimi i fjalëve të saj dhe ripërtëritja e kuptimeve të tyre,
- Instalimi i ri i vlerave shpirtërore, ideore dhe njerëzore,
- Zhvillimi i shkencave gjuhësore, përkujdesja dhe prosperiteti për to,
- Ruajtja e elokuencës arabe nga degradimet dhe zhdukja, para sfidave të gjuhëve të huaja, filozofirave aristoteliane dhe përkthimeve greke.

Ndërsa sa iu përket gjurmëve të Kur'anit Famëlartë në gjuhën arabe, atëherë përmbledhja e tyre do të përfshinte disa aspekte, si:

- Kur'ani i shpëtoi arabët nga kundërthëniet e shumta dialektike fisnore dhe punoi në drejtim të përafrimit të dialekteve dhe gjuhëve, duke aprovuar kështu të folurit me dialektet më letrare të arabishtes. Allahu i Madhëruar e shpalli Kur'anin në dialektin e kurejshëve, por, megjithëkëtë, Ai i ruajti edhe dallimet ndërdialektore, kështu që Kur'ani u shpall në shtatë dialekte.
- Kur'ani e pastroi gjuhën arabe nga fjalët e huaja (barbarizmat) duke e shndërruar në një gjuhë të kulluar, tërheqëse dhe me stil elegant dhe joshës.
- Kur'ani i solli arabishtes edhe fjalë të reja, të panjohura dhe të pashprehura deri në atë kohë, si: *islam, iman, furkan, shirk, kufr, nifak, savm, salat, zekat* etj.
- Kur'ani i mbizotëroi kapacitetet letrare dhe tërhoqi vëmendjen dhe interesimin e tyre me metodat më të theksuara dhe veçoritë letrare më të spikatura. Dijetaret i kushtuan rëndësi shprehjes kur'anore nga aspekte të ndryshme, për të caktuar domethënien dhe kuptimin e saj, si dhe studiuan përbërjen e fjalëve, gjë që çoi deri tek Ilmu'n Nahv (sintaksa). Pastaj ata iu qasën ndërtimit të brendshëm të fjalëve, gjë që pati për pasojë Ilmu's Sarf-in (morfologjinë). Ndërsa Ilmu'l Belagah (retorika dhe elokuenca) lindën si rezultat i studimit të modeleve ekspresive (shprehëse) artistike në Kur'an.

Ky referim shkencor mëton të hedhë dritë pikërisht mbi këto aspekte të ndritshme për të sqaruar rrjedhimisht vlerën dhe gjurmët e Kur'anit në ruajtjen e gjuhës arabe nga humbja dhe shkrirja, duke iu referuar studimeve dhe analizave shkencore të dijetarëve dhe ekspertëve të vjetër dhe bashkëkohorë.

Hyrje

Falënderimet i takojnë Allahut! Përshëndetjet qofshin mbi pejgamberin Muhammed, familjen, shokët dhe pasuesit e tij!

Gjëja për të cilën kanë rënë dakord të gjithë, e madje ka edhe konsensus (ixhma') tek të gjitha gjeneratat, *selefi* (të parët) dhe *halefi* (të mëvonshmit), është se mësimi i diturive fetare, njohja e urtësive kur'anore dhe atyre pejgamberike, është obligim për çdo musliman në moshë të rritur dhe të mençur. Meqenëse dy burimet fetare, Kur'ani dhe Sunneti, janë në gjuhën arabe, atëherë nuk ka rrugë tjetër të mësimit dhe të kuptimit të tyre përveçse nëpërmjet mësimit të gjuhës arabe, e 'ajo, pa të cilën nuk mund të përmbushet një obligim, është obligim' -thotë rregulli.

Fatkeqësisht, disa njerëz i përtuan mësimin të gjuhës arabe kështu u mjaftuan dhe u mbështetën në përkthime të ndryshme të teksteve kur'anore dhe pejgamberike, kështu që e viktimizuan veten për shkak të kuptimit, interpretimit dhe komentimit të gabuar. Ai që do ta mësojë Kur'anin dhe sunnetin gjithsesi duhet ta mësojë me përpikëri gjuhën arabe. Allahu i Madhëruar, në Kur'anin Famëlartë, thotë:

"E edhe ai (Kur'ani) është shpallje (zbritje) e Zotit të botëve. 193. Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili). 194. (E solli) Në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen (pejgamber). 195. (Të shpallëm) Me gjuhë të kulluar arabe." (esh-Shuara, 192-195.)

"Prandaj, Ne të shpallëm ty Kur'anin arabisht që ta këshillosh kryefshatin (Mekën) dhe ata përreth saj, dhe t'u tërheqësh vërejtjen për

ditën e tubimit (kiametit), për të cilën nuk ka dyshim. Një grup për në xhenet, kurse një grup për në zjarr.” (esh-Shura, 7.)

“Kështu Ne e shpallëm këtë Kur'an arabisht dhe përsëritëm në të vërejtjet, në mënyrë që ata të ruhen ose ai (Kur'ani) t'u sjellë atyre përvojë mësimi.” (Taha, 113.)

“Libër që ajetet e tij janë të shkoqitura, duke qenë Kur'an arabisht për një popull që di ta kuptojë.” (Fussilet, 3.)

“Ne e zbritëm atë Kur'an arabisht, ashtu që ta kuptoni.” (Jusuf, 2.)

“S'ka dyshim se Ne e bëmë atë Kur'an arabisht, në mënyrë që ju ta kuptoni.” (ez-Zuhruf, 3.)

“Duke qenë Kur'ani arabisht që nuk ka kundërthënie, me qëllim që të ruhen prej rrugës së gabuar.” (ez-Zumer, 28.)

Në këto ajete të bekuara vërehet shumë qartë shenjtëria dhe arabia (gjuha arabe) e Kur'anit, sikurse që theksohet edhe zhveshja e arabishtes nga kundërthëniet dhe shtrembërimet, gjë që nuk mund të thuhet për gjuhët e tjera.

Dijetarët e gjeneratave tona të para e kuptuan rëndësinë e mësimi, nxënies përmendsh dhe përhapjes së fesë së Allahut, kështu që ata iu qasën mësimi të arabishtes, edhe pse në fakt nuk ishin arabë, gjë e cila u mundësoi atyre të arrijnë pozita shumë të larta në shkencat islame, siç ishin, ta zëmë, imamët Taberiu, Raziu, Buhariu, Muslimi, Sibeveji, e shumë të tjerë. Me përhapjen e Islamit në botë, u përhap edhe gjuha arabe, madje edhe jashtë trevave arabishtfolëse. Besimtarët e rinj ia mësynë Kur'anit për ta mësuar, për ta mbajtur mend përmendsh dhe për t'ua mësuar atë të tjerëve. Kur'ani Fisnik sikur i kishte dhënë një ngjyrë shenjtërie arabishtes, kështu që muslimani që dëshironte ta mësonte dhe kuptonte Kur'anin Fisnik, patjetër se i duhej të ndiqte kurse tek dijetarët për gjuhën arabe.

Gjuha arabe përgjatë historisë pati batica e zbatica, pati edhe sulme të pamëshirshme nga orientalistë dhe pasues të tyre. Por ishte mirësia e

Allahut ajo që e ruajti Kur'anin, e rrjedhimisht edhe gjuhën arabe nga fati i simotrave të saj. Për këtë, fillim e mbarim, i detyrohem vetëm Allahut! E tillë është mirësia e Allahut, me të cilën Ai nderon kë të dojë!

Përshëndetjet qofshin mbi zotërinë dhe peygamberin tonë, Muhammedin, familjen dhe shokët e tij!

I. VLERA E KUR'ANIT FISNIK PËR GJUHËN ARABE

Të folurit e Kur'anit për ndikimin e tij në gjuhën arabe është si të folurit e diçkaje për vetveten, kjo ngase Kur'ani është i formuluar në arabisht me kuptime të qarta. Allahu zgjodhi për librin e Vet gjuhën më elokuente dhe si të tillë ia shpalli Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], që të jetë mrekullia e mrekullive, lëndore e kuptimore, deri në amshim. Mrekullia kur'anore është dëshmia më e madhe për peygamberin e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]. Vlen të theksohet se Kur'ani u shpall në një mjedis që shquhej për një potencial të fortë gjuhësor dhe për një elokuencë të madhe, gjë që do të thotë se ai iu përshtat rrethanave dhe gjendjes së popullit tek të cilët u shpall fillimisht. Politeistët mekas dhe ata të vendeve fqinje kishin kualifikim të lartë në gjuhë, oratori, ligjërime dhe elokuencë, dhe mu për këtë prijataret e shkencave gjuhësore: semantikës, retorikës dhe elokuencës iu takonin atyre.

Kur'ani, në lidhje me arabishten, ka edhe një meritë tjetër të madhe të pamohuar. Pasioni dhe dashuria për mësimin e Kur'anit që motivoi edhe për mësimin e arabishtes në mënyrë të pastër dhe të rrjedhshme (pa gabime gramatikore), teori të cilën e mbrojnë edhe gjuhëtarët¹. Prof. Dr. Hasen Dijauddin Ater, një kolegu im nga Universiteti Taiba, në librin e tij *el-Mu'xhizetu'l Halidetu*, thotë: "*Arabët arritën shkallën më të lartë të elokuencës dhe oratorisë që mund ta ketë pasur ndonjëherë njerëzimi dhe krijuan epërsi ndaj të gjithë popujve. E shpallja e Kur'anit nga Allahu i Madhëruar në gjuhën e të Dërguarit, Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], pati dobi të shumta. Asnjë mrekulli nuk mund të matet (krahasohet) me të (Kur'anin). Sikur çështja e tij të*

¹ Xhebri, Abdullah Ibn Nasir, *Lehexhatu'l arab fi'l Kur'ani'l Kerim – dirasetun tahlilijetun*, Daru'l kutub el-ilmijeh, b.1, Lubnan, 2007, f. 206.

kufizohej në mrekulli lëndore, siç ishte shndërrimi i shkopit në gjarpër tek Musai (alejhi's selam) apo ringjallja e të vdekurve tek Isai (alejhi's selam), gjëra të huaja për mentalitetin e tyre, ndoshta ata do të paragjykonin se u sfiduan për të bërë diç të ngjashme vetëm për këtë shkak. E meqë Allahu e veçoi Muhammedin (alejhi's selam) me Kur'an, Ai nuk iu la vend fare për këtë dyshim, ngase oratoria ishte tradita dhe krenaria e tyre. Kur'ani ishte sfidues ndaj asaj që ata ia dinin karakteristikat dhe epërsinë me një reflektim (meditim) të shkurtër. Kjo mënyrë e qëlluar, përkitazi me mrekullitë, është vetë urtësia, andaj nuk preferohet largimi prej saj...²

Ndërsa Kadi Ijjadi ka thënë: -E prej aspekteve të pallogaritshme që dëshmojnë paimitueshmërinë – pamundësinë e sfidimit të tij (ar. í'xhazin), për dallim nga mrekullitë e pejgamberëve të mëparshëm që përfunduan me vdekjen e tyre dhe për të cilat sot ka mbetur vetëm njoftimi për to, është edhe mbetja e tij fakt i përjetshëm aq sa të ekzistojë kjo botë. Madje, siç thotë Allahu, Ai ka garantuar për këtë (ruajtje të tij)³:

“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.” (el-Hixhr, 9.)

“Atij nuk mund t'i vishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit.” (Fussilet, 42.)

Allahu i Madhëruar i sfidoi politeistët dhe mosbesimtarët kurejshë, të cilët ishin prijës të oratorisë dhe elokuencës dhe të cilët e kundërshtuan Pejgamberin Muhammed, që të sillnin diç të ngjashme me të, qoftë edhe vetëm një sure apo qoftë edhe vetëm një ajet. Natyrisht ata nuk mundën dhe askush nuk do të ketë mundësi për diçka të tillë, gjer në kiamet. Allahu thotë:

“E në qoftë se jeni në dyshim për atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit Tonë, atëherë silleni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur'ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotët) pos All-llahut, nëse jeni të singërtë (në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit).” (el-Bekare, 23.)

² Ater, Hasen Dijauddin, *El-Mu'xhizetu'l halidetu*, Daru nuri'l mektebat, Xhiddeh, b.4, 2005, f. 110.

³ Ijad, Kadi, *esh-Shifa bi ta'rifi hukuki'l Mustafa*, el-Matbaatu'l uthmanijeh, Egjipt, 1312h., f.232.

"Përkundër kësaj, ata (idhujtarët) thonë se atë e trilloi ai (Muhammedi). Ti thuaj: "Silleni pra ju një kaptinë të ngjashme me këtë, madje thirrni kë të doni për ndihmë, pos All-llahut, po qe se jeni të drejtë në atë që thoni"." (Junus, 38.)

"Apo, pse ata thonë: "Ai (Muhammedi) e trilloi atë (Kur'anin)". Thuaj: "Formuloni pra dhjetë kaptina si ai (Kur'ani) ashtu të trilluara (siç thoni ju) dhe thirrni, pos All-llahut, po qe se jeni të drejtë (çka thoni), kë të mundeni për ndihmë!"" (Hud, 13.)

"Thuaj: "Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të bënin si ky, sado që do ta ndihmonin njëri - tjetrin"." (el-Isra, 88.)

Imam Thealebiu e kishte kuptuar thelbësisht këtë të vërtetë, të cilën kishte arritur ta formulonte skajshmërisht bukur në parathënien e librit të tij të famshëm *Fikhu'l lugati ve sirr-rru'l arabijeh* (Të kuptuarit e gjuhës dhe sekretit i arabishtes), ku ka thënë: *"Kush e do Allahun e Madhëruar, do ta dojë doemos edhe të Dërguarin e Tij, Muhammedin, e kush e do peygamberin arab, do t'i dojë edhe arabët, e kush i do arabët, e do edhe arabishten, e kush e do arabishten, interesohet për të, insiston në të dhe i kushton rëndësi. E atij që Allahu e ka udhëzuar për në Islam, ia ka hapur gjoksin për besim, i ka dhënë sinqeritet dhe e ka bërë të besojë se Muhammedi është më i miri prej peygamberëve, arabët më të mirët prej popujve, arabishtja më e mira nga gjuhët dhe se mësimi i saj është prej fesë, ngase është mjet i diturisë, çelës i të kuptuarit në fe dhe shkak i përmirësimit të jetës në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe sikur të mos ketë pasur motiv tjetër në përvetësimin e veçorive të saj, në qëndrimin për të mësuar format e mënyrat e saj, në thellimin për të kuptuar çështjet e përgjithshme dhe ato të veçanta, përveç bindjes së fortë në njohjen e I'xhazit të Kur'anit dhe fakteve që dëshmojnë peygamberinë e Muhammedit (alejhi's selam), shtyllë kjo e besimit, do t'i mjaftonte si nder pasoja pozitive, frytet e së cilës do të ishin të këndshme në të dy botët."*⁴

Dijetarët kanë përmendur se, kohët e fundit, injoranca në lidhje me fenë dhe gjuhën arabe ka bërë që origjinaliteti i kësaj gjuhe dhe të folurit e saj në mënyrën letrare është bërë diç e huaj për njerëzit. Sikur Allahu i

⁴ Eth-Thealebi, *Fikhu'l lugati ve sirr-rru'l arabijeti*,..., Kajro, 1938, f.1.

Madhëruar të mos i mëshironte këta muslimanë nëpërmjet udhëzimit kur'anor dhe ruajtjes së trashëgimisë gjuhësore dhe retorikes kur'anore, nëpërmjet punimeve dhe studimeve gjuhësore nga dijetarë të singertë, arabishten do ta ndiqte fati i gjuhëve të tjera që u zhdukën e u shkrinë. Prof. Muhammed Hashimi thotë: *'Është fakt i pranuar se zbritja e Kur'anit në gjuhën arabe ka ndikuar në mënyrë të pamohueshme në stabilizimin dhe përforcimin e kësaj gjuhe, sikurse që ka ndikuar në forcimin e pozitës së saj ndërmjet gjuhëve të tjera, në përmirësimin dhe korrigjimin e saj, në zgjerimin e objektivave të saj ekspresive (shprehëse) dhe arteve të të folurit të saj. Kjo mund të vërehet shumë qartë në shumëllojshmërinë e kuptimeve, imagjinatave, metodave dhe fjalëve.*

E po kështu vërehet qartë edhe ndikimi i Kur'anit tek arabët meqë në gjuhën e tyre u mishërua bukuria, retorika, elokuenca dhe, po ashtu, shoqërimi me të i zbuti zemrat e tyre të ngurta dhe natyrat e tyre të vrazhda. Kur'ani i dhuroi gjuhës arabe shprehje të bukura, stil tërheqës, radhitje fantastike, fuqi argumentuese, logjikë të ekuilibruar, saktësi në performancë, bollëk në domethënie...

Një prej meritave të Kur'anit ndaj gjuhës arabe ishte edhe zhveshja e saj nga ajo që ishte si diç e huaj, e çuditshme, në diç të lehtë dhe të qëndrueshme, si dhe sqarimi i qëllimit dhe arritja e synimit me mënyrat dhe metodat më të qarta të mundshme. E sa shpesh muslimanët kanë lagur buzët e tyre me Kur'an në namazet dhe adhurimet e tyre dhe kanë zbuluar imazhet e letërsisë së mrekullueshme dhe sfiduese (të pamposhtur) në shprehjet, shembujt, metaforat, metonimitë dhe dramatikën e tij...

Kur'ani Famëlartë, edhe pse ka të përbashkët me gjuhën arabe lëndën dhe kombinimin (e fjalëve), megjithatë, dallon në metodë, doktrinë, pozitë dhe përpunim. Në të kundërt, Kur'ani do të shkrihej në të folurit e tyre dhe rrjedha e tij do të ishte rrjedhë e poezive, ligjërimeve, tregimeve etj. Shembulli i tij atëherë do të ishte si i atyre gjërave që mbesin nga njeriu. Por jo, Allahu refuzoi që fati i fakteve dhe dëshmimeve (të librit) të Tij të mbetej asisoj, kështu që e shpalli Kur'anin si përfshirës të shkaqeve më të rëndësishme të ngritjes (promovimit, përparimit) ndaj dominimit, veçimit apo dallimit... Shpallja e tij në këtë mënyrë mrekulluese ishte shkak për ruajtjen e gjuhës arabe dhe zhvillimin e shkencave të saj. E baza e kësaj ishte sfidimi me të, një prej urtësive së të cilit ishte që arabët të shikonin metodat kur'anore dhe aspektet e strukturës së tij, në mënyrë që të meditonin për

metodën e tij dhe të përpiqeshin më pas të shihnin nëse kishin mundësi për të bërë diç të ngjashme me të, derisa të bindeshin se ishin të dobët para tij... Kështu, Kur'ani famëlartë solli domethënie, metoda dhe struktura të reja gjuhësore, të panjohura deri më atëherë për arabët, e gjëra të tjera të cilat e pasuruan arabishten dhe i dhuruan asaj saktësi dhe bukuri...'⁵ Kur'ani, po kështu, i dhuroi gjuhës arabe edhe qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë gjer në amshim, gjë për të cilën falënderimi i takon Allahut, fillim e mbarim!

Kur'ani, sipas asaj që pohojnë njëzëri dijetarët dhe hulumtuesit, jo vetëm që e ka ruajtur gjuhën arabe por ka ruajtur edhe dialektet nëpërmjet *kiraeteve* (formave të leximit) të cilat gjeneratat na i përcollën besnikërisht deri më sot. Në këtë thesar shkencor madhështor reflekton edhe vlera e Islamit, të cilin Allahu e zgjodhi si fe për të gjitha botët dhe fati i gjuhës arabe dhe muslimanëve padyshim se është i lidhur me fatin e kësaj feje dhe zbatimin e ligjeve, dispozitave, urdhëresave dhe ndalesave të saj. Përkitazi me këtë të vërtetë shkencore disa dijetarë pohojnë: *'E sigurisht që dihet se historia e njerëzimit nuk njeh gjuhë të cilën e ka përjetësuar libri i saj, përveç arabishtes së cilës Kur'ani i dhuroi kurorën e jetës dhe sekretin e ekzistimit. Ky libër ruajti tekste nga dialektet e arabëve, në elokuencën dhe shëndoshmërinë e të cilave nuk ka dyshim për sa i përket aspektit gjuhësor dhe performancës së tyre. Këtë natyrisht e bëri nëpërmjet kiraeteve, të cilat paraqesin një metodë transmetimi, saktësinë e të cilit nuk mund ta arrijë asnjë shkencë, madje as metodologjitë bashkëkohore... Po kështu është e njohur se, kur është bërë kodifikimi i gjuhës arabe, mbështetja kryesore kanë qenë fjalët e Kur'anit, pastaj ato të poezive të sakta, fjalët nga fjalori i fiseve që nuk kanë qenë të ndikuara nga elemente të huaja, si: fisi kajs, temim, hudhejl, esed etj. Kur'ani është ai që i ka ruajtur të shëndosha bazat e arabishtes dhe, po të mos ishte ai, mund të pohohet me lehtësi se çdo vend arab do të kishte gjuhën e vet dhe se ato, për gjuhën letrare, do të ishin sikurse frëngjishtja, italishtja e spanjishtja për gjuhën latine. Pra, fati i arabishtes është i lidhur me fatin e fesë dhe, për këtë shkak, e tashmja e ummetit është e ndërlidhur me të kaluarën e tij dhe arabishtja ka arritur ta ruajë veten e saj...'*⁶

⁵ <http://arabic.bayyanat.org.lb/nachratbayyanat/idaaat/idaat218.htm>

⁶ Për më shumë shih: *Lehexhatu'l arab fi'l Kur'ani'l Kerim – dirasetun istikraijjetun tahlilijjetun* të Abdullah AbdunNasir Xhebri, f. 73-141.

*'Kur'ani është lloj gjuhësor me të cilin vazhdojnë të identifikohen ithtarët e tij, realisht apo kuptimisht, aq sa të ketë njerëz mbi sipërfaqen e kësaj toke. Sikur të mos ishte kjo arabishte që e ruajti Kur'ani Fisnik, historia islame nuk do të ishte e qëndrueshme, ummeti nuk do të mbetej i bashkuar dhe as që do të shquhej për unitetin islamik.'*⁷

II. NDIKIMI I KUR'ANIT FISNIK NË GJUHËN ARABE

Çdo gjuhë, siç thonë hulumtuesit, vazhdon varësisht nga folësit e saj; ajo ngrihet me ngritjen e tyre dhe dobësohet me dobësimin e tyre. Ky imazh shoqëror i nënshtrohet ligjit të evolucionit. Historia na raporton për shumë gjuhë dhe kultura të cilat shijuan fatin e hidhur të humbjes dhe zhdukjes, gjë që nuk i ndodhi kulturës islame dhe gjuhës arabe, të cilën e ruajti Kur'ani Fisnik. Kështu, gjuha arabe mbeti gjuha më e fortë në rezistimin ndaj sfidave dhe vështirësive në kohën kur arabët u përzier me të huajt, falë elementeve kulturore dhe civilizuese që i ka fituar në sajë të të qenit gjuhë e Kur'anit.

Njerëzimi, përgjatë gjithë historisë, nuk ka njohur ndonjë gjuhë që është përjetësuar falë librit të saj fetar. Kur'ani i ka vënë kurorën e jetës dhe sekretin e ekzistencës gjuhës arabe dhe pikërisht prej tij gjuha arabe mori shpirtin e vendosmërisë dhe guximshmërinë e jetës. Kur'ani Fisnik është shpirti që e bëri arabishten letrare gjuhë të të gjitha kohëve. Për çdo të mirë arabishtja, së pari, i detyrohet Kur'anit. Allahu qoftë i falënderuar fillim e mbarim!⁸

⁷ Shih: Ater, Hasen Dijauddin, *El Mu'xhizetu'l halideh*, 372-392; El-Halidi, Salah el-Fettah, *I'xhazu'l Kur'ani'l bejanij ve delailu masdarihi'rr rrebbanijj*, f. 491-506.

⁸ Për më shumë shih: *Lehexhatu'l arab fi'l Kur'ani'l Kerim – dirasetun istikraijjetun tahlilijjetun*, f. 210.; *Etheru'l Kur'ani'l Kerim fi'l lugati'l arabijjeh*, Ahmed Hasen Bakuri, Darul mearif, Egjipt, ..., f. 28-32.

Ndikimin dhe gjurmët e Kur'anit në gjuhën arabe do të mund t'i përmbledhim në pikat në vijim:

1. Ruajtja e gjuhës arabe nga humbja

Ndikimi i Kur'anit në gjuhën arabe, nga aspekti përmbajtësor dhe formal, ka qenë vërtet i madh. Tekstet e Kur'anit janë të shenjta dhe të përjetshme, kështu që me ekzistencën e vazhdueshme të teksteve kur'anore edhe gjuha arabe vazhdoi të jetë e gjallë dhe aktive gjer në ditët tona. Dr. Jusuf Sherbexhi është munduar të përmbledhë disa nga sekretet që qëndrojnë pas përjetësisë së gjuhës arabe: *'Sekreti që qëndron pas përjetësimit të gjuhës arabe dhe ruajtjes së saj është ndikimi i madh i Kur'anit në jetën e ummetit arab, të cilin nga një ummet i humbur ai e shndërroi në një ummet të ndershëm e të fortë, dhe këtë për hir të mbajtjes së tij pas këtij libri (Kur'anit), i cili gdhendi (përsosi) shpirtrat e tyre, fuqizoi karakterin e tyre, pastroi mendjet e tyre nga ndyrësira e idhujtarisë, bashkoi zemrat e tyre dhe unifikoi fjalët e tyre e rrjedhimisht edhe idealet, kështu që për hir të tyre ata sakrifikuan edhe jetët. Kur'ani largoi edhe padrejtësitë ndërmjet tyre si dhe shkuli nga gjokset e tyre urrejtjen, smirën, mërinë dhe inatet... Kur'ani ishte sikurse një kodër e lartë që i sfidonte ndikimet dhe kurthet që ngriheshin kundër gjuhës së tij, e mbronte atë dhe ruante prapenat e saj... E megjë Kur'ani ka këtë pozitë, atëherë nuk është çudi pse muslimanët iu qasën atij dhe e mbrojnë atë, duke konsideruar se çdo armiqësi ndaj Kur'anit është armiqësi edhe ndaj arabishtes dhe anasjelltas. Kësisoj, sekreti i qëndrimit të Kur'anit deri më sot, e me lejen dhe dëshirën e Allahut gjer në amshim, fshihet pikërisht në mbrojtjen që Ai ia bën Kur'anit, ngase mbrojtja e tij nënkupton edhe mbrojtjen e saj... Këtë gjë më së miri mund ta kuptojë ai që përcjell gjuhët dhe fatin e tyre. Sa e sa gjuhë kanë qenë të ngritura, madje edhe në nivel ndërkombëtar, por më pas kanë humbur. Si shembull për këtë shih gjuhën latine, e cila dikur ishte gjuhë, kulturë dhe fuqi, por sot nuk ka mbetur asgjë përveç gjurmëve të saj. Gjuha arabe nuk e pati fatin që të ishte as fuqi, as gjuhë kulture e as prodhimi; ajo ishte gjuhë shkretëtire dhe analfabetësh dhe larg shkencave dhe njohurive, por falë Kur'anit Famëlartë, ruajtjen e të cilit e mori përsipër vetë*

Allahu, ajo u ruajt, për dallim nga librat e tjerë dhe gjuhët e tyre që nuk e patën këtë fat dhe u shuan...⁹

2. Forcimi i gjuhës dhe veprimi në drejtim të përkryerjes së saj

Askush nuk dyshon se Kur'ani është burim i forcës, fuqisë dhe gjallërisë së gjuhës arabe, ndryshe, sikur ky potencial hyjnor të mungonte, atëherë gjuha arabe sigurisht se nuk do t'i dispononte këto domethënie të shumta, shprehje të zhvilluara, struktura të reja dhe metoda të larta që ka. Shkencëtari i madh, Rafiu, thotë: *"Kur'ani u shpall asisoj që shumica e pakica e tij (tekstet e gjata e të shkurtra) sfidojnë. Ai është i ngjashëm me nurin (dritën) në mbarështimin (renditjen) e tij, ngase drita është dritë në tërësi dhe edhe kur ndahet nuk del jashtë natyrës së saj. Kur'ani në çdo pjesë të tij është tërësi, që nuk kanë kundërthënie ndërmjet vete, përveç nëse krijon qiell tjetër nga ky dhe tokë tjetër nga kjo. Kjo është arritur falë faktit se Kur'ani e filtoi gjuhën arabe nga shakullinat (zhiblat) dhe arriti që ta demonstrojë thelbin dhe esencën e fshehtësive të saj publikisht, kështu që me ujin e bukurisë erdhi më i mbushur se reja, me gjallërinë fizike më i mirë se rinia... Pastaj, në trajtimin e domethënieve delikate dhe të thukëta, të cilat i shfaq nëpërmjet l'xhazit dhe të cilat i portretizon me të vërtetën dhe i shpreh me alegorinë, për të vazhduar me atë elasticitetin që ia ka dhënë për ndërrimin e metodave dhe shndërrimin e strukturave, në të gjitha këto Kur'ani ka shfaqur një pamje imponante që të mahnit, jo vetëm për gjeneratën e arabëve por për tërë historinë. Këtu ka qenë fshehtësia e shtangies së tyre derisa të vërtetonin se a ishin duke dëgjuar zë të së tanishmes, zë të së ardhmes apo zë të përjetësisë, ngase arabishtja ishte gjuha që ata e njihnin."*¹⁰

Me gjithë sulmet e pamëshirshme ndaj gjuhës arabe dhe përhapjes së dialekteve popullore në formën e planprogrameve nëpër shkolla dhe universitete, madje në disa universitete amerikane dhe arabe u themeluan edhe departamente të veçanta, ata e pranuan se gjuha arabe disponon një

⁹ Shih: Bakuri, Ahmed Hasen, *Etheru'l Kur'ani'l Kerim fi'l-lugati'l arabijeh*, f.23; <http://www.al-maqha.com/t7344.html> Webfaqja është shfletuar më datë 20/05/2010.

¹⁰ Err-Rafii, Sadik, *Tarihu adabi'l arab*, v.2, f.74.

fuqi, gjallëri dhe përhapje të shpejtë. Orientalisti Ernest Renan thotë: *“Ndoshta gjëja më e çuditshme që ka ndodhur në historinë e njerëzimit, - sekreti i së cilës është vështirë të zbulohet, - është përhapja e gjuhës arabe. Kjo gjuhë në fillim ishte e panjohur dhe befas u shfaq shumë madhështore. Fillim e çfarë fillimi, pasuri e çfarë pasurie. E përsosur në kuptimin e asaj se, deri në ditët tona, nuk ka ndodhur ndonjë ndërrim i rëndësishëm i saj; ajo nuk ka fëmijëri dhe as pleqëri; që në fillim u shfaq e plotë dhe stabile, e ndoshta ajo që më së shumti të mahnit është mbjellja e saj në një shkretëtirë dhe arritja e përsosmërisë pikërisht në shkretëtirë, madje duke kaluar simotrat e saj me shprehje të shumta, domethënie precize dhe strukturë fenomenale...”* Ndërsa Xhorxh Sartoni thotë: *“Gjuha e Kur’anit, duke e llogaritur atë si gjuhë të arabëve, me këtë reformim ka qenë e plotë. Pejgamberi [alejhissalatu ves selam] i dha fleksibilitet aq sa e bëri të aftë të kodifikojë madje edhe shpalljen hyjnore në mënyrë shumë precize dhe ta shprehë atë me shprehje të bukura dhe të forta. Kështu, Kur’ani arrin ta lartësojë gjuhën arabe në pozitën e ‘shembullit më të lartë’ (methelu’l a’la) në shprehjen e qëllimeve.”* Kurse Broklemani (Brookleman) shton: *“Falë Kur’anit, arabishtja arriti një shtrirje të tillë që thuhet nuk e ka asnjë gjuhë tjetër. Muslimanët janë të vetëdijshëm dhe besojnë se gjuha arabe është e vetmja gjuhë që lejohet të përdoret në lutjet (namazet) e tyre. Kjo i ka mundësuar arabishtes që të fitojë një pozitë të lartë ndaj të gjitha gjuhëve të botës...”*

Prof. Dr. Hasen Dijaud-din Ater, në studimin e tij përkitazi me mrekullinë më të madhe të Kur’anit, përmend edhe disa pika të tjera me rëndësi për ndikimin e Kur’anit në gjuhën arabe, të cilave po iu referohem shkurtimisht:

- Kur’ani i Madhërishëm i shpëtoi arabët nga dallimet e ndryshme dhe të shumta dialektike, kështu që ndikoi në drejtim të përafrimit dhe unifikimit të gjuhës së tyre, për të folur me dialektin më letrar të arabishtes...
- Kur’ani e pastroi arabishten nga shprehjet e huaja dhe të paqarta dhe e shndërroi atë në një gjuhë të kulluar dhe tërheqëse
- Kur’ani solli domethënie të reja që arabët nuk i njihnin dhe as nuk dinin t’i shprehnin, si: *Islam, iman, furkan, shirk, kufr, nifak, savm, salat, zekat* etj. Krahës kësaj ai solli edhe aspekte përmbajtësore ndijore

interesante dhe të përjetshme, siç është – fjala vjen – tërheqja e vëmendjes për *melekutus semavati ve'l erd* - madhësitë e qiejve e të tokës dhe përfitimi i argumenteve logjike që dëshmojnë njëshmërinë, madhështinë dhe fuqinë e Zotit, si dhe obligimin e adhurimit vetëm të Tij... Allahu i Gjithëditur e shpalli Kur'anin në 114 pjesë, me një elokuencë dhe retorikë të pakrahasueshme në shprehjet dhe domethëniet e tij, si dhe në formën dhe përmbajtjen e tij...

- Arabët e patën bërë zakon që në stinë dhe tregje të ndryshme të organizonin gara letrare. Në të shumtën e rasteve, tek konkurrentët ndodhnin mospajtime për shkak të mungesës së një shembulli letrar më të lartë, të cilin do të mund ta merrnin për kriter vlerësimi. E kur Kur'ani i befasoi ata me madhështinë e elokuencës së tij, epërsinë e retorikës së tij dhe pozitën e pakonkurrencë të tij, ata iu nënshtruan dhe u bindën se ai nuk mund të sfidohej. Aftësitë dhe kapacitetet e tyre letrare iu nënshtruan atij dhe ata filluan të merrnin prej tij. Ata iu qasën studimit të karakterit të bukur letrar që solli ai, prej të cilit formuan një mori rregullash retorike dhe letrare. Me një fjalë, Kur'ani ishte modeli më i mirë i mundshëm dhe peshorja më e saktë.
- Gjurmët e Kur'anit ende vazhdojnë të shfaqen qartë në letërsinë arabe: në poezi, prozë, urtësi, ligjërime e çfarëdo tjetër qoftë. Në të shfaqen shprehje dhe forma të shkëputura direkt prej Kur'anit, por ka edhe të atilla që janë formuluar duke shikuar në formalen dhe mënyrën e tij. Ndërsa sa iu përket temave, disa janë tërësisht të reja, si: sofizmi dhe asketizmi, por ka edhe të atilla që janë reformuar dhe iu është dhënë forcë dhe gjallëri, si entuziazmi, por që të gjitha këto tema janë ndikuar qartazi nga Kur'ani, gjë për të cilën nuk ka dyshim. Kjo mund të vërehet në vlerat e reja e të shumta shpirtërore, intelektuale, shoqërore dhe njerëzore që këto tema kanë marrë nga Kur'ani...
- Kur'ani mbizotëroi mbi kapacitetet letrare dhe tërhoqi interesimin dhe kujdesin e tyre. Sigurisht se nderi i krijimit dhe zhvillimit të shkencave gjuhësore i takon Kur'anit. Kur'ani është arbitri i këtyre shkencave, fjala e të cilit është gjithçka për to dhe jo anasjelltas.

Vërtet është për t'u çuditur me punën e disa injorantëve që duan të bëjnë pikërisht të kundërtën: të krijojnë paqartësi rreth teksteve kur'anore dhe rregullave të gjuhës arabe. Këta natyrisht se e neglizhojnë faktin se Kur'ani është gjykues i këtyre shkencave. Argumenti kur'anor është vendim i prerë për mendimet kundërtëhenëse në të gjitha shkencat gjuhësore... Si rezultat i kësaj u shkruan disa vepra madhështore, si *Nudhumu'l Kur'an* e Xhahidhit, *Delailu'l I'xhaz* dhe *Esraru'l belagah* e Abdu'l Kadir Xhurxhanit, etj.

- Kur'ani, siç mund të jetë e qartë për ty lexues i nderuar dhe për çdo studiues, është lënda që vë në lëvizje kritikën letrare tek arabët dhe është hulumtuesi kryesor drejtuar atyre dhe studimeve retorike në përgjithësi. Po u ndale të analizosh studimet kritike dhe peshojat e tyre në artet e fjalës (*funun el kavl*) do të gjesh se të gjitha i janë nënshtruar mënyrës kur'anore, të cilën na e kanë paraqitur studimet e I'xhazit të Kur'anit, sikurse që janë thirrur në argumentin apo faktin kur'anor, i cili ka qenë shembulli më i mirë dhe modeli vlerësues më i pranuar. Prej mënyrës dhe formës së tij (Kur'anit), bëhet edhe gjykimi për vlerat e metodave ndaj njëra-tjetrës...
- Kur u intensifikuan studimet, përkitazi me komentimin (tefsirin) e Kur'anit dhe aspektit të I'xhazit në retorikën e tij, atëherë hulumtimet u thelluan në masë të konsiderueshme në shkencën e artit ekspresiv apo shprehimor (ar. *Ilmu'dh-Dhevk*¹¹), kështu që doli në shesh ndikimi i Kur'anit në zhvillimin e shijes letrare arabe.

3. Unifikimi i dialekteve arabe

Është e ditur se dialektet e gjuhës arabe ishin të ndryshme; ato përmbanin pjesë të çmuara letrare, por kishin edhe gjëra krejtësisht të pavlera. Kur'ani

¹¹ Fjala *Dhevk* në letërsi nënkupton një ndjenjë kuptimore në bazë të së cilës bëhet vlerësimi i ndikimit letrar apo artistik. Shih: Mes'ud, Xhubran, *Err-Rraid - mu'xhemun lugavijjun asrijjun*, Daru'l Ilm lil melajin, Bejrut, f. 376 (shën. i përkth).

u shpall në shtatë shkronja (dialekte), në mënyrë që leximi dhe recitimi i tij të ishte i lehtë për të gjithë. Padyshim, dialektet dallonin edhe nga shkalla dhe niveli i aspektit letrar, gjë që bëri që Uthmani [Allahu qoftë i kënaqur me të] të nxirrte një dekret që, me rastin e kodifikimit apo përmbledhjes së Kur'anit brenda një mus'hafi, po që se ndodhte ndonjë diskutim rreth shprehjeve, atëherë të merrej shprehja e kurejshëve, ngase Kur'ani që shpallur në gjuhën e tyre.

Gjuha apo dialekti i kurejshëve ishte më e qarta, më e lehta dhe më e ëmbla, ndaj të gjitha dialekteve të Gadishullit, vlerë të cilën mundohet ta shpalosë para nesh edhe Imami i shquar, Sujuti [Allahu e mëshiroftë], i cili thotë: “... të folurit e kurejshëve është më i lehti dhe më i qarti, ndërsa të folurit e arabëve është paksa i vrazhdë dhe i pakuptueshëm. Për këtë shkak, arabët i afrohen asaj dhe duan ta përvetësojnë atë, sidomos kur kanë parë se bukurinë dhe ëmbëlsinë e saj e ka shtuar edhe Kur'ani. Ata, kur panë këtë bukuri, iu qasën Kur'anit për ta dëgjuar atë dhe, përkundër vullnetit dhe dëshirës së tyre, thanë: Vërtet, qenka i ëmbël dhe elegant (magjepsës); lartësia e tij është frytdhënëse, ndërsa pjesa e poshtme e tij gufuese. Vërtet, ai triumfon, ndërsa mbi të nuk mund të triumfohet!”¹²

Muslimanët vazhduan ta lexojnë Kur'anin ditë e natë, derisa e vërtetuan në praktikë se vërtet ata janë njerëzit më të mirë të dalë ndonjëherë në sipërfaqen e dheut, duke e lexuar atë që të gjithë, arabë dhe joarabë, me një gjuhë të vetme, gjuhë që i unifikoi ata, duke shkruar deri diku ato dallimet që i kishin para shpalljes së Kur'anit në dialektet e tyre. Kësisoj, ata hynë në një etapë të re historike, në të cilën u bë unifikimi i gjuhëve të tyre...¹³

Mbase është e njohur se arabët, para shpalljes së Islamit, kishin dallime në të folur. Ata mblidheshin për çdo vit në tregun Ukkadh, sikurse edhe gjatë kohës së Haxhit, në të cilat merrnin pjesë një grup i madh ligjëruesish, poetësh dhe gojëtarësh. Në këtë kongres tregtar shkencor – nëse mund të quhet kështu – ata shkëmbenin dhe diskutonin me njëri-tjetrin, formë kjo e

¹² Këto në fakt janë fjalët e Utbe Ibn Rebiat të thëna me rastin e dëgjimit të leximit të kaptinës Fussilet nga Pejgamberi [alejhiss salatu ves selam]. Shih: Tefsiru Ibni Kethir, 3/150.

¹³ Sujuti, *el-Muz'hir fi ulumi-l-lugati-l-arabijjeti*, 1/129.

njohur për pasurimin e dialekteve, derisa në skenë u paraqit Islami, libri i të cilit u shpall në gjuhën e kulluar arabe, duke shkaktuar kështu një revolucion shkencor dhe linguistik të ri, metodën dhe stilin e të cilit arabët nxituan ta përvetësojnë pa hezitim¹⁴. Së shpejti Kur'ani u bë qendër referuese për vlerësimet gjuhësore dhe afrimin ndërdialektor. Në të kaluarën shkrirja në një dialekt tjetër konsiderohej turp, ndërsa me shpalljen e Islamit muslimanët e mësuan gjuhën nga Kur'ani dhe nga metoda e tij, dhe jo vetëm arabët. Kësisoj, dialektet do të hidheshin në koshin e plehrave të historisë, ndërsa gjuha arabe me çlirimet islame do të bëhej edhe gjuhë e atyre vendeve, siç ishte rasti me Shamin, Irakun, Egjiptin, Persinë etj. Statusi i saj do të ndërrohej nga gjuhë fetare në gjuhë populli dhe shteti.¹⁵ Ajo u bë gjuha e vetme për të gjithë muslimanët në botë, me të cilën ata mund ta adhurojnë Zotin e tyre. Imamët e katër medhhebeve janë pajtuar njëzëri se nuk lejohet falja e namazit me gjuhë joarabe.

4. Transformimi i arabishtes në gjuhë botërore

Gjuha, siç dihet, është paraqitja më korrekte e jetës së atyre që e flasin atë, dhe në rastin e arabëve, para shpalljes së Kur'anit, ajo nuk ishte e njohur ngase arabët nuk shquheshin për diç apo nuk kishin ndonjë pozitë tek popujt, në mënyrë që njerëzit t'i qaseshin mësimit të gjuhës së tyre apo të lidhnin bashkëpunim me ta. Gjuha e tyre nuk ishte gjuhë e shkencës dhe dijes, e krahas kësaj arabët nuk kishin ndonjë civilizim a prodhimtari të caktuar. Tërë kjo bëri që arabishtja të mos mund të dilte jashtë Gadishullit Arabik. Kësisoj jetuan arabët derisa erdhi Kur'ani, i cili solli parimet dhe normat më të përkryera që njeh shoqëria njerëzore. Kur'ani ia garantoi arabishtes jo vetëm mbijetesën por edhe zhvillimin dhe jetëgjatësinë, dhe ja, arabishtja sot është e gjallë dhe shume e fortë, është gjuhë e miliona njerëzve në mbarë botën. E duke e ditur se arabishtja është qenësore për të

¹⁴ Shih: *Lehexhat el-arab fi-l-Kur'ani-l-Kerim – dirasetun istikraijjetun tahlilijjetun*, f. 207.

¹⁵ Ibid.

mbajtur fenë dhe për ta kuptuar saktë atë, njerëzit iu qasën mësimi të saj si gjuhë e Kur'anit. Andaj, nëse themi se po të mos ishte Kur'ani arabishtja nuk do ta kishte këtë fat, nuk gabojmë.

5. Shpikja e disa shkencave që nuk do të ekzistonin pa Kur'anin

U shpikën shkencat të reja në disa fusha, si në rrafshin fetar: Hadithi, Fikhu, Usuli Fikhu; në gjuhë: Sintaksa, Morfologjia, Elokuenca, Të kuptuarit e gjuhës (fiku-l-lugah); në shkencat filozofike: Logjika, Filozofia Islame, Teuhidi, Apologetika e shkencat të tjera.

6. Mbizotërimi ndaj gjuhëve fqinje

Këtë të vërtetë e kuptojmë atëherë kur bëjmë krahasime të arabishtes me gjuhët e tjera, si: anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja etj.

Ndërsa sa i përket ndikimit të Kur'anit në shpirtat e besimtarëve e jobesimtarëve, atëherë fol e mos ki frikë fare. E si mund të mos ndikohet shpirti i njeriut prej Kur'anit, kur edhe bota inorganike, kodrat dhe malet, ndikohen prej tij?! Një prej atyre që kanë folur vërtet bukur për këtë çështje është edhe Prof. Dr. Salah Abdu'l Fettah el-Halidi, në studimin e të cilit gjenden mësimet e dobi të shumta, prej të cilave, për t'i dhënë një pamje më complete punimit, por edhe një koncept më të elaboruar lexuesit, mendoj se ia vlen të shkëpusim ca paragrafë:

“Kur'ani ka një ndikim të jashtëzakonshëm në shpirtin e njeriut, gjë që dëshmon se është fjalë e Allahut, ndryshe, ndikim të tillë tek njeriu nuk mund të lë kurrë fjala e njeriut. E vërteta, të folurit elokuent ndikon tek shpirtat e ndërgjegjshëm, qofshin këto fjalë prozë a poezi, dhe sa herë që elokuenca është më e theksuar, edhe ndikimi rritet, por asnjëherë sikurse ndikimi nga fjala e Allahut. Kur'ani ka aluduar në ndikimin e tij që është ekskluziv për nga lloji, që madje sikur Allahu

t'iu drejtohej me të edhe krijesave inorganike, ato do të ndikoheshin prej tij. Allahu ka thënë:

“Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur'an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga All-llahu. Këta janë shembuj që ua shkoqisim njerëzve, që ata të mendojnë.” (el-Hashr, 21.)

Mosbesimtarët janë të privuar nga Kur'ani ndikues, e sikur Allahu t'ia shpallte këtë Kur'an ndonjë kodre, do ta shihje kodrën tek përulej dhe çahet nga frika e Allahut. Por jo, Allahu nuk iu drejtua me të kodrave. Ai iu drejtua njeriut, i cili gjithsesi se duhet të ndikohet prej Kur'anit dhe, rrjedhimisht, edhe t'ia ketë frikën Allahut. Fatkeqësisht, jo të gjithë njerëzit janë ndikuar prej tij. Ka të atillë madje që edhe ia kanë kthyer shpinën. Kur e dëgjojnë atë, ata ikin prej tij, e kështu zemrat e tyre bëhen më të forta se guri. Ata e pengojnë depërtimin e Kur'anit në zemrat e tyre dhe kështu bëjnë krim ndaj vetvetes. Allahu thotë:

Kur ti e lexon Kur'anin, në mes teje dhe atyre që nuk e besojnë botën tjetër, Ne vëmë një perde të padukshme. 46. Ndërkaq, në zemrat e tyre vëmë një mbulesë dhe shurdhim të thellë të veshëve të tyre që nuk mund ta kuptojnë atë. E kur e përmend ti në Kur'an Zotin tënd, vetëm Atë, ata ikin mbrapa dhe largohen.” (el-Isra, 45-46.)

Në fakt, mosbesimtarët e dinin ndikimin e Kur'anit në shpirtra, kështu që frikësoheshin që ta dëgjonin atë, andaj edhe “e këshillonin” njëri-tjetrin që të qëndronin sa më larg tij, e po të ndodhte që të lexohej në prani të tyre, atëherë ata të shushuritnin e të pëshpëritnin vetëm e vetëm që të mos dëgjohej ai. Allahu na flet për këtë:

Ata që nuk besuan thanë: "Mos e dëgjoni këtë Kur'an dhe kur të lexohet ai, ju bëni zhurmë (bërtitni) ashtu që ta pengoni!" (Fussilet, 26.)

Kur'ani patjetër se ndikon tek njerëzit. Mu për këtë Islami kërkon prej ithtarëve të tij që t'ua lexojnë Kur'anin mosbesimtarëve dhe t'i bëjnë ata ta dëgjojnë Kur'anin, ngase do të ndikohen prej tij.

E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t'i dëgjojë fjalët e All-llahut (Kur'anin), e mandej përcille deri në vendin e

tij të sigurt. Këtë, ngase ata janë popull që nuk e di (të vërtetën e fesë islame).” (et-Teubeh, 6.)

Kjo kishte të bënte me ndikimin tek mosbesimtarët, ndryshe tek besimtarët, që i kanë zemrat të hapura për dritat e Kur’anit, ndikimi është i madh.

All-llahu e shpalli të folmen më të mirë, librin, të ngjashëm në mrekulli, të përsëritur herë pas here (me këshilla e dispozita), që prej (dëgjimit të) tij rrëqethen lëkurët dhe zemrat e tyre. Ky (libër) është udhëzim i All-llahut, me të udhëzon atë që do. E atë që All-llahu e lë të humbur, për të nuk ka ndonjë udhëzues.” (ez-Zumer, 23)¹⁶

Dr. Halidij-i ka sjellë edhe shembuj nga ndikimi praktik i Kur’anit në shpirtrat e mosbesimtarëve, si tregimi i tre liderëve kurejshë që e dëgjuan Kur’anin tek Qabeja tri net radhazi. Pastaj ka sjellë shembuj nga ndikimi i Kur’anit tek sahabët, si tregimi i pranimit të Islamit nga Omer Ibn Hattabi, [Allahu qoftë i kënaqur me të], pastaj tregimi i martirit Sejjid Kutbit me gruan jugosllave në vitin 1949, e cila u ndikua shumë nga ajetet kur’anore gjatë udhëtimit me anije nga Egjipti në SHBA.

Si rezyme të këtyre fjalëve, në fund të këtij referimi, do të mund të konstatojmë se vlera e Kur’anit dhe ndikimi i tij i madh nuk ka qenë vetëm në gjuhën arabe dhe në ruajtjen dhe pasurimin e saj, por në çdo gjë: kozmos, krijesa dhe botë.

Kjo është dhurata e Zotit, që Ai ia jep kujt të dojë, e Allahu është Dhurues i Madh, ndërsa lutja jonë e fundit është:

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Shërbyesi i Kur’anit dhe Sunnetit

¹⁶ Shih: Salah, Abdu’l Fettah el-Halidijj, *I’xhazu’l Kur’an el-bejaniij ve delailu masdarihi’rr Rrebbaniij*, f.491-492; *Min axhaibi’l Kur’ani’l lugavijjeti* te Dr. Fuad Mahmud Muhammed Senedi, f. 41-101.

Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

28/6/2010

Prizren, Kosovë

Bibliografi

1. Abdu'l Halik Adimeh, *Dirasatun li uslubi'l Kur'ani'l Kerim*, b.1, 1373 h., Mekke, Saudi.
2. Ater, hasen Dijauddin, *El Mu'xhizetu'l halideh*, Daru nuri'l mektebat, Xhiddeh, b.4, 2005.
3. Bakuri, Ahmed Hasen, *Etheru'l Kur'ani'l Kerim fi'l-lugati'l arabijjeh*, Daru'l mearif, Egjipt.
4. El-Halidi, Salah el-Fettah, *I'xhazu'l Kur'ani'l bejanijj ve delailu masdarihi'rr rrebbanijj*, Daru Ammar, b.3, 2008, Amman, Jordan.
5. El-Munavi, Mahmud Fevzi, *Meta jetekel-lemu'l ilmu el arabijjete – et tibbu nemudhexhen*, Merkez El-Melik Fejsal lil buhuth ve'd dirasatt el islamijjeh, Saudi.
6. El-Xhundi, Enver, *El-Lugatu'l arabijjetu bejne humatiha ve husumiha*, Matbatu'rr rrisale, Bejrut.
7. Err-Rrafii, Sadik, *Tarihu adabi'l arab*, b.2, Daru'l kitabi'l arabijj, Bejrut, 1974.
8. Eth-Thealebi, *Fikhu'l lugati ve sirr-rru'l arabijjeh*, Kajro, 1938.
9. Ibni Kethir, *Tefsiru'l Kur'ani'l Adhim*, Matbatu Misrijjeh, b.1, 1400 h.
10. Ijjad, kadi, *Esh-Shifa bi ta'rifi hukuki'l Mustafa*, El Matbatu'l uthmanijjeh, Egjipt, 1312 h.

11. *Mexhel-letu'd dirasati'l kur'anijeh*, nr.2, 1429 h., Xhamiatu'l Imami Muhammed Ibn Suud el Islamijeh, El-Xhemijjetuu'l ilmijeh es suudijeh li'l Kur'ani'l Kerim ve ulumihi, Rijad, Saudi.
12. *Mexhel-letu'l buhuthi ve'd dirasati'l kur'anijeh*, revistë shkencore e nxjerrë ekskluzivisht për Kur'anin, nr.4, Vizaretu shuuni'l islamijeh ve'l evkaf ve'd da'veh ve'l irsha, Saudi.
13. *Mexhel-letu'l xhamiati'l islamijeh*, nr.144, v.41, 1429h., Medine, Saudi.
14. Mutabekani, Mazin Ibni Salah, *El-Istishrak el muasir fi mendhuri'l Islam*, Daru eshbilija, b.1, 2000.
15. Senedi, Fuad Mahmud, *Min axhaibi'l Kur'an el-lugavijjeti*, edicioni i tretë i Multeka el ehibbeh, Mekke, b.1, 2008.
16. Sujuti, Xhelaud din AbduRrahman, *El Muz'hiru fi ulumi'l lugatil arabijeh*, rec. Muhammed Ebu'l Fadl Ibrahim, b.1, Egjipt.
17. <http://www.nayli.com/vb/showthread.php?=9862>.
18. <http://arabic.bayyanat.org.lb/nachratbayyanat/idaat/idaat218.htm>
19. <http://www.al-maqha.com/t7344.html>

